



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 2117/13 prot

Koplik më: 02/08/2022

V E N D I M

Nr 29, Datë 29 / 07 / 2022

**PËR  
MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/NË PËRDORIMTË SIPERFAQES PYJORE PËR  
NDERTIMIN E HEC-eve“ KOZHNJE 1 DHE KOZHNJE 2 TAMARË NGA SHOQERIA  
“TAMARA HYDRO ENERGY” SH.P.K DHE HEQJEN NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQES 0,88  
HA QË BËJNË PJESE NË EKONOMINË PYJORE KULLOSORE “VUKEL-NIKC”.**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika e/l nenit 64 germa c, ligjin nr.57/2020 “Për Pyjet”, si dhe VKM nr.591, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.1353, datë 10.10.2008”, “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, VKM nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacioni të fondit kullor”, të ndryshuar, Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1, dt.09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”. VKM nr. 391 dt.21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” si dhe bazuar në VKM. Nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive”, të ndryshuar.



## VENDOSI:

1. Dhënien me qira /në përdorim të sipërfaqes pyjore **14,874 ha** që shtrihen në ngasirat sipas tabelës bashkangjitur raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.
2. Vlera totale e dhënies me qira në vit është 1.659.191,5 (njemilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e nente mijë e njëqind e nentëdhjetë e një presje pesë)lekë.
3. Vlerën e investimeve që do të kryhen (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj.) si dhe vlerën e bimësisë pyjore, florës, faunës.  
për sipërfaqen që do të zëvendësoj sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor për 0,88 Ha = 1 049 877 lekë.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore",

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 29.07.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.8.2022

